



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
KOMISIONI I DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT**

Nr. 98 Prot.

Tiranë, më 26.09.2022

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662. datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 23, datë 26.09.2022 si më poshtë:

**Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

- 1. Dosje Personale nr. 5004 “Blerimi”** në ngarkim të R. Z., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Dega e Punëve të Brendshme Dibër.
- 2. Dosje Formulare nr. 5075**, në ngarkim të M. D., me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 46 (dyzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

